



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.119

11 shtator

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.559, datë 22.8.2007	Për bashkimin e disa instituteve të Akademisë së Shkencave, organizimin e tyre në Qendrën e Studimeve Albanologjike, si dhe funksionimin e kësaj Qendre në periudhën kalimtare.....	3383
Vendim i KM nr.560, datë 22.8.2007	Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare	3386
Vendim i KM nr.561, datë 22.8.2007	Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Gjeoshkencave, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare.....	3388
Vendim i KM nr.562, datë 22.8.2007	Për shkëputjen e Institutit të Kërkimeve Biologjike nga Akademia e Shkencave dhe integrimin e tij në Universitetin e Tiranës	3391
Vendim i KM nr.563, datë 22.8.2007	Për krijimin e Qendrës së Fizikës Bërthamore të zbatuar dhe Autoritetit Atomik Shqiptar, pranë Universitetit të Tiranës	3392
Vendim i KM nr.566, datë 5.9.2007	Për miratimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit, në të holla, për vitin 2007.....	3394

VENDIM
Nr.559, datë 22.8.2007

**PËR BASHKIMIN E DISA INSTITUTEVE TË AKADEMISË SË SHKENCAVE,
ORGANIZIMIN E TYRE NË QENDRËN E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, SI DHE
FUNKSIONIMIN E KËSAJ QENDRE NË PERIUdhËN KALIMTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 41 e vijues të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrisë të Arsimit e Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkimin e Institutit të Arkeologjisë, Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Institutit të Kulturës Popullore, Institutit të Historisë, Qendrës Enciklopedike Shqiptare dhe Qendrës së Studimeve të Artit dhe organizimin e tyre në Qendrën e Studimeve Albanologjike (QSA), me statusin e personit juridik.

2. QSA-ja kryen kërkimin shkencor, formimin universitar të thelluar të studentëve dhe shkencëtarëve, si dhe shërbime e transferime të njohurive, në fushat e identitetit, të kulturës, pasurive materiale e shpirtërore e të historisë së botës shqiptare.

3. Detyrat kryesore të QSA-se janë:

a) Përpunimi i mendimit shkencor të përparuar, që t’i paraprijë zhvillimeve shoqërore e kulturore, ekonomike e politike etj., si dhe të shërbejë si një mbështetje e fuqishme, për përpunimin e politikave publike në këto fusha;

b) Përhapja e dijeve dhe e vlerave në shoqëri, nëpërmjet mediatizimit të tyre, si dhe formave të tjera të transmetimit të informacionit;

c) Mbledhja dhe studimi i materialeve burimore, klasifikimi dhe arkivimi i tyre;

ç) Zhvillimi i teknikave dhe i metodave, për ruajtjen dhe restaurimin e vlerave;

d) Transmetimi i dijeve të fituara nga kërkimi shkencor te studentët dhe shkencëtarët, nëpërmjet formimeve të përparuara.

4. QSA-ja kalon një periudhë kalimtare, nga një deri në dy vjet, gjatë së cilës do të organizohet në njësi përbërëse, si institute dhe grupe kërkimore-mësimore, si më poshtë vijon:

a) Instituti i Arkeologjisë;

b) Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë;

c) Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit;

ç) Instituti i Historisë;

d) Grupi Kërkimor i Enciklopedisë Shqiptare.

5. Organet dhe autoritetet drejtuese të QSA-së janë:

a) Këshilli drejtues;

b) Drejtoria;

c) Drejtori i Qendrës;

ç) Këshillat shkencore të instituteve;

d) Drejtuesit e njësive përbërëse.

6. Detyrat e këshillit drejtues të Qendrës. Këshilli drejtues drejton veprimtarinë e QSA-së gjatë periudhës kalimtare deri në zgjedhjen e organeve dhe të autoriteteve drejtuese të saj.

Detyrat kryesore të këshillit drejtues janë:

a) Harton kuadrin rregullator të veprimtarisë së QSA-së (statutin, rregulloret etj.);

b) Harton dhe miraton planin afatgjatë të zhvillimit të QSA-së, mbështetur edhe në propozimet e këshillave shkencore të instituteve;

c) Përcakton, në bashkëpunim me këshillat shkencore të instituteve, për periudhën kalimtare, fushat parësore të kërkimit dhe formimit universitar dhe, në varësi të tyre, ngre grupet kërkimore-mësimore;

ç) Përcakton kriteret e punësimit dhe mbikëqyr politikën e personelit në QSA;

d) Drejton procedurat e konkurrimit të hapur, për emërimin e titullarëve të grupeve kërkimore-

mësimore;

dh) Harton raportin vjetor të veprimtarisë (përfshirë atë financiar), si dhe atë përfundimtar, në mbyllje të periudhës kalimtare dhe ia dërgon, për miratim, Ministrit të Arsimit dhe Shkencës;

e) I propozon ministrit të Arsimit dhe Shkencës, në përfundim të periudhës kalimtare, shpalljen e zgjedhjeve të organeve dhe autoriteteve drejtuese të QSA-së, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë;

ë) Përgatit dhe drejton procesin e zgjedhjes së organeve dhe të autoriteteve drejtuese të QSA-së, në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.

7. Përbërja e këshillit drejtues të QSA-së.

Këshilli drejtues përbëhet nga 13 anëtarë: nga drejtori, i cili është edhe kryetari i këshillit drejtues i kësaj Qendre, kancelari, drejtuesit e njësive përbërëse, të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, dhe 6 anëtarë të jashtëm, të emëruar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në bazë të rekomandimeve të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës.

Anëtarët e jashtëm janë figura të njohura në fushën akademike dhe të politikave të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Anëtarët e këshillit drejtues shpërblehen në bazë të vendimit nr.120, datë 27.1.1997 të Këshillit të Ministrave “Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumetacionit shkollor”.

Përgjegjësit e grupeve kërkimore-mësimore, të cilët nuk janë anëtarë të këshillit drejtues, si dhe nëndrejtori i QSA-së marrin pjesë në mbledhjet e këshillit pa të drejtë vote.

8. Detyrat e dhe përbërja e drejtorisë së QSA-së.

Drejtoria e QSA-së është autoriteti kryesor, i cili drejton, nën mbikëqyrjen e këshillit drejtues dhe në bashkëpunim me drejtuesit e njësive përbërëse, veprimtarinë e përditshme të Qendrës.

Drejtoria e QSA-së përbëhet nga:

- a) Drejtori;
- b) Nëndrejtori;
- c) Kancelari.

9. Këshillat shkencore të instituteve.

Këshilli shkencor i institutit drejton veprimtarinë kërkimore e mësimore të tij dhe funksionon si një organ kolegjal vendimmarrës. Këshilli shkencor, për periudhën kalimtare, përbëhet nga i gjithë personeli akademik i institutit, që ka, së paku, gradën shkencore “Doktor”.

10. Drejtori i QSA-së, për periudhën kalimtare, emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në bazë të rekomandimeve të bëra nga Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës.

Drejtori i QSA-së, për periudhën kalimtare, emëron dhe shkarkon nëndrejtorin dhe drejtuesit e njësive përbërëse. Kancelari emërohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe përzgjidhet ndërmjet tre kandidaturave të propozuara nga këshilli drejtues.

11. Veprimtaria financiare dhe administrative e QSA-së realizohet përmes një administrate qëndrore.

Niveli i pagave të punonjësve të QSA-së do të jetë i njëjtë me atë të personelit akademik respektiv në institucionet publike të arsimit të lartë.

Marrëdhëniet e punës së punonjësve rregullohen sipas dispozitave të ligjit për arsimin e lartë.

12. Në numrin e përgjithshëm të punonjësve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, miratuar me vendimin nr.244, datë 7.3.2007 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve në ministritë dhe institucionet qëndrore, për vitin 2007”, shtohen 112 veta, për QSA-në, dhe 8 veta, për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të cilët, në total, i pakësohen numrit të punonjësve të Akademisë së Shkencave, miratuar për periudhën 1 shtator - 31 dhjetor.

Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t’i shtohet fondi prej 2 766 000 (dy milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh, për paga dhe sigurime shoqërore, të cilat i pakësohen buxhetit, të miratuar për Akademinë e Shkencave.

Përgjashtimisht për vitin 2007, fondi prej 38 900 000 (tridhjetë e tetë milionë e nëntëqind mijë) lekësh, për paga dhe sigurime shoqërore për QSA-në, do të shpenzohen dhe raportohen në grupin 22, në Buxhetin e Shtetit, miratuar për Akademinë e Shkencave.

13. Struktura dhe organika e QSA-së përgatiten në bazë të numrit të përgjithshëm të

punonjësve, të miratuar në pikën 12 të këtij vendimi dhe miratohet nga këshilli drejtues i kësaj Qendre.

14. QSA-ja financohet nga Buxheti i Shtetit, i cili përfshihet brenda buxhetit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe nga burime të tjera, të ligjshme.

QSA-ja përfiton, në bazë të konkurrencës, nga programi i financimit shtetëror të projekteve për kërkim shkencor.

Gjithashtu, mund të përfitojë financime edhe nga subjekte private, të interesuara për kërkimin e tyre shkencor apo për ofrimin e shërbimeve brenda fushave të veprimtarisë së saj.

15. Gjatë periudhës kalimtare QSA-ja do të ketë varësi administrative nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, e cila do të kontrollojë dhe auditojë përdorimin e fondeve buxhetore, zhvillimin e procesit të kërkimit, si dhe të gjithë ecurinë e Qendrës. Pas mbarimit të kësaj periudhe, QSA-ja do të funksionojë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë.

16. Pjesë të ish-Institutit të Arkeologjisë (muzetë arkeologjike në Durrës, Apoloni, Butrint e Korçë) i shkëputen këtij instituti dhe transferohen në inventarin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për ngritjen e shërbimit arkeologjik.

17. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve bashkëpunon me QSA-në për kryerjen e veprimtarisë kërkimore-shkencore në këto njësi.

Mënyra e bashkëpunimit përcaktohet me urdhër të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

18. Asetet, burimet financiare dhe vlerat e këtyre instituteve, u kalojnë, përkatësisht:

a) QSA-së të gjitha asetet (burime financiare, mjedise, zyra, revista, automjete, donacione, programe zhvillimi, orëndi, infrastrukturë informatike, rrjet telefonik etj.), të instituteve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe arkivat shkencore e çdo dokumentacion tjetër arkivor i tyre, me përjashtim të vlerave dhe pasurive të paluajtshme, të përmendura në shkronjat “b” e “c” të kësaj pike.

b) Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve pasuritë e paluajtshme dhe të gjitha vlerat e ekspozueshme, në funksion të shërbimit arkeologjik, të përcaktuara në pikën 16, të këtij vendimi.

c) Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të cilat i kalojnë, gjithashtu, në inventar, vlerat e ekspozueshme të arkivit të ish-Institutit të Kulturës Popullore, për t’i përdorur në shërbim të turizmit kulturor.

19. Ngarkohen Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Kryetari i Akademisë së Shkencave të përgatisin urdhrin e përbashkët, për inventarizimin e aseteve e të pasurive dhe ndarjen e tyre, përkatësisht për secilin institucion, sipas këtij vendimi.

20. Vendimi nr.197, datë 18.3.1996 i Këshillit të Ministrave “Për rrjetin e institucioneve shkencore shtetërore”, shfuqizohet.

21. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Financave dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.560, datë 22.8.2007

PËR BASHKIMIN E DISA INSTITUTEVE DHE NJËSIVE KËRKIMORE, ORGANIZIMIN E TYRE NË INSTITUTIN E ENERGJISË, UJIT DHE MJEDISIT, PRANË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUTIT NË PERIUDHËN KALIMTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkimin e ish-Institutit të Hidrometeorologjisë dhe ish-Qendrës së Kërkimeve Hidraulike, të Akademisë së Shkencave, dhe organizimin e tyre në Institutin e Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (INEUM), si njësi kryesore, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës.

2. Misioni i Institutit të Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (INEUM) përfshin:

- a) Kërkimin shkencor, bazë dhe të aplikuar;
- b) Formimin universitar të thelluar të studentëve dhe shkencëtarëve;
- c) Shërbime për të tretë, si dhe transferimin e njohurive dhe teknologjisë, në fushat e energjisë, ujit, mjedisit dhe klimës.

Të gjitha shërbimet shtetërore, që kryejnë institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, bëhen pjesë e misionit dhe e detyrave të INEUM-it.

3. Detyrat kryesore të INEUM-it janë:

- a) Vlerësimi i potencialeve natyrore energjetike dhe, veçanërisht, i formave të energjise së rinovueshme;
- b) Vlerësimi i aftësive transformuese të energjisë, impaktet mjedisore dhe hartimi i programeve kombëtare të shkarkimit të gazrave (Protokolli i KIOTO-s);
- c) Studimi i ndryshimeve, klimatike dhe ujore, si dhe i impakteve të tyre ekonomiko-shoqërore;
- ç) Parashikimi i dukurive e i proceseve atmosferike, të motit dhe klimës, i dhe i dukurive të jashtëzakonshme atmosferike;
- d) Studimi i gjendjes së mjedisit dhe i prirjeve të nivelit të ndotjes së tij;
- dh) Studimi i pasurive të ujërave për veprat hidroenergjetike, hidroteknike dhe portuale, me risqe të mëdha dhe impakt mjedisor;
- e) Formimi universitar, kryesisht në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve, dhe kualifikimi shkencor i shkencëtarëve të rinj.

4. INEUM-i kalon një periudhë kalimtare nga 1 deri në 2 vjet, gjatë së cilës organizohet në njësitë përbërëse, departamente dhe grupe kërkimore-mësimore, si më poshtë vijon:

- a) Departamenti i Teknologjive Energjetike;
 - b) Departamenti i Ekonomisë së Ujit;
 - c) Departamenti i Klimës dhe Mjedisit.
5. Organet dhe autoritetet drejtuese të INEUM-it janë:

- a) Këshilli drejtues;
- b) Drejtoria;
- c) Drejtori;
- ç) Përgjegjësit e departamenteve.

6. Detyrat e këshillit drejtues të INEUM-it

Këshilli drejtues drejton veprimtarinë e këtij instituti gjatë periudhës kalimtare deri në zgjedhjen e organeve dhe të autoriteteve drejtuese.

Detyrat kryesore të këshillit drejtues janë:

- a) Harton kuadrin rregullator të veprimtarisë së Institutit të Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (rregulloret etj.);
- b) Harton planin afatgjatë të zhvillimit të Institutit të Energjisë, Ujit dhe Mjedisit dhe ia paraqet, për miratim, senatit akademik të UPT-së;
- c) Përcakton fushat parësore të kërkimit dhe formimit universitar dhe, në varësi të tyre, i propozon senatit grupet kërkimore — mësimore, që do të ngrihen në INEUM;
- ç) Përcakton kriteret e punësimit të personelit akademik;
- d) Drejton procedurat e konkurrimit të hapur, për emërimin e titullarëve të grupeve kërkimore - mësimore;
- dh) Harton raportin vjetor të veprimtarisë (përfshirë atë financiar), si dhe raportin përfundimtar, në mbyllje të periudhës kalimtare, e ia dërgon senatit për miratim;
- e) I propozon rektorit të UPT-së, në përfundim të periudhës kalimtare, shpalljen e zgjedhjeve të organeve dhe autoriteteve drejtuese të INEUM-it, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë.
- ë) Përgatit dhe drejton procesin e zgjedhjes së organeve kolegjiale dhe të autoriteteve drejtuese të institutit, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë.

7. Përbërja e këshillit drejtues të INEUM-it.

Këshilli drejtues përbëhet nga 9 anëtarë: nga drejtori i INEUM-it, i cili është edhe kryetari i

këshillit drejtues, katër anëtarë të brendshëm, (përgjegjësit e departamenteve të INEUM-it), dhe 4 anëtarë të jashtëm, të emëruar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës, në bazë të propozimit të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës.

Anëtarët e jashtëm janë figura të njohura në fushën akademike dhe të politikave të arsimit të lartë e të shkencës.

Anëtarët e keshillit shpërblehen në bazë të vendimit nr.120, datë 27.1.1997 të Këshillit të Ministrave, “Për shpërblimin e autoreve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor”.

Nëndrejtori dhe kancelari i INEUM-it marrin pjesë në mbledhjet e keshillit, pa të drejtë vote.

8. Detyrat dhe përbërja e drejtorisë së Institutit të Energjisë, Ujit dhe Mjedisit

Drejtorja e INEUM-it është autoriteti kryesor, i cili drejton, nën mbikëqyrjen e keshillit drejtues, veprimtarinë e përditshme të këtij instituti. Drejtorja përbëhet nga:

a) Drejtori;

b) Nëndrejtori;

c) Kancelari.

9. Për periudhën kalimtare, Ministri i Arsimit dhe Shkencës emëron dhe shkarkon drejtorin, në bazë të propozimit të bërë nga Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës. Nëndrejtori emërohet dhe shkarkohet nga drejtori i INEUM-it. Kancelari emërohet nga rektori i UPT-së, në bazë të propozimit të keshillit drejtues.

10. Departamentet e INEUM-it drejtohen nga përgjegjësit, të cilët, për periudhën kalimtare, emërohen dhe shkarkohen nga drejtori i këtij instituti.

11. INEUM-i përfaqësohet në senatin e Universitetit Politeknik të Tiranës nga drejtori dhe 2 (dy) anëtarë, personel akademik, që kanë, së paku, gradën “Doktor”, të cilët përzgjidhen nga keshilli drejtues, në bazë të propozimeve të bëra nga departamentet e këtij instituti.

12. Veprimtaria financiare dhe administrative e INEUM-it realizohet përmes administratës qendrore të UPT-së.

Niveli i pagave të punonjësve të INEUM-it do të jetë i njëjtë me atë të personelit akademik respektiv në institucionet publike të arsimit të lartë.

Marrëdhëniet e punës së punonjësve rregullohen sipas dispozitave të ligjit për arsimin e lartë.

13. Në numrin e përgjithshëm të punonjësve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, miratuar me vendimin nr.244, datë 7.3.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve në ministrinë dhe institucionet qendrore, për vitin 2007”, shtohen 35 veta, për INEUM-in, të cilët pakësohen nga numri i punonjësve, të miratuar për periudhën 1 shtator-31 dhjetor, për Akademinë e Shkencave, së bashku me fondet buxhetore, për paga dhe sigurime shoqërore, në vlerën 12 150 000 (dymbëdhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

14. Për përmbushjen e detyrave të shërbimit hidrologjik dhe meteorologjik, INEUM-i angazhon punëtorë, vërtetues-regjistruar, jashtë organikës, kundrejt një pagese, sipas tarifave të përcaktuara në vendimin nr.406, datë 19.6.1995 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

15. Struktura dhe organika e INEUM-it përgatiten nga keshilli drejtues në bazë të numrit të përgjithshëm të punonjësve, të miratuar në pikën 13 të këtij vendimi dhe miratohen nga rektori i UPT-së.

16. INEUM-i financohet nga Buxheti i Shtetit, i cili përfshihet brenda buxhetit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për UPT-në, si dhe nga burime të tjera, të ligjshme. INEUM-i përfiton, në bazë të konkurrencës, nga programi i financimit shtetëror të projekteve për kërkim shkencor.

INEUM-i mund të përfitojë financime edhe nga subjekte private, të interesuara për kërkimin e tyre shkencor apo për ofrimin e shërbimeve ndaj të tretëve, brenda misionit të vet.

17. INEUM-it i kalojnë të gjitha asetet, burimet financiare, mjediset e punës, laboratorët, zyrat, automjetet, donacionet, projektet e kërkimit e të zhvillimit, orëditë, infrastruktura informatike, rrjeti telefonik, si dhe arkivat shkencore e çdo dokumentacion tjetër arkivor, i instituteve dhe njësive, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi.

Pasuritë e paluajtshme, të cilat transferohen, janë, si më poshtë vijon:

a) Ndërtesa qendrore e Institutit të Hidrometeorologjisë, Tiranë;

b) Observatori i Institutit të Hidrometeorologjisë, Tiranë;

c) Observatori i Institutit të Hidrometeorologjisë, Durrës;

- c) Observatori i Institutit të Hidrometeorologjisë, Uji i Ftohtë (Vlorë);
- d) Observatori i Institutit të Hidrometeorologjisë, Treportit (Vlorë);
- dh) Observatori i Institutit të Hidrometeorologjisë, Shkodër;
- e) Observatori i Institutit të Hidrometeorologjisë, Kukës;
- ë) Ndërtesa e Kërkimeve Hidraulike, laborator i modelimeve, stacioni i pompave etj.;
- f) Magazinë;
- g) Mjediset (përfshirë edhe mjediset e laboratorëve) dhe zyrat e ish- Institutit të Mjedisit.

18. Ngarkohen Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe kryetari i Akademisë së Shkencave të përgatisin urdhrin e përbashkët, për inventarizimin dhe transferimin e aseteve të pasurive dhe ndarjen e tyre, përkatësisht për secilin institucion, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

19. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM Nr.561, datë 22.8.2007

PËR BASHKIMIN E DISA INSTITUTEVE DHE NJËSIVE KËRKIMORE, ORGANIZIMIN E TYRE NË INSTITUTIN E GJEOSHKENCAVE, PRANË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUTIT NË PERIUdhËN KALIMTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Arsimit e Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkimin e Institutit të Sizmologjisë, të Akademisë së Shkencave, me disa nga njësitë kërkimore të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, përkatësisht, Drejtorinë e Administrimit të Territorit dhe Pasurive Minerale, Drejtorinë e Gjeoinformatizimit, Drejtorinë e Gjeofizikës së Aplikuar dhe Topogjeodezisë, të cilat shpëputen nga ky shërbim, si dhe organizimin e tyre në Institutin e Gjeoshkencave (IGJEO), si njësi kryesore, pranë UPT-së.

2. Instituti i Gjeoshkencave ka për mision:

- a) kërkimin shkencor, bazë dhe të aplikuar;
- b) formimin universitar, të thelluar, të studentëve dhe shkencëtarëve;
- c) shërbimet për të tretë, në fushën e sizmologjisë, dhe transferimin e njohurive e të teknologjisë, në fushat e sizmologjisë, pasurive natyrore, të gjeoriskut, gjeoinxhinierisë dhe gjeoinformacionit.

3. Detyrat kryesore të IGJEO-s janë:

- a) Studimi i fenomeneve gjeologjike (gjeofizike, gjeokimike, gjeomekanike etj.), dhe ndërtimi i hartave gjeologjike, tematike;
- b) Studimi dhe vlerësimi i pasurive minerale, të materialeve të ndërtimit, burimeve nëntokësore, të energjisë dhe resurseve ujore nëntokësore;
- c) Studimi gjeopedologjik i territorit;
- ç) Studimi i reziqeve natyrore (gjeoriskut) dhe të atyre të shkaktuara nga veprimtaria e njeriut (rreshqitjet, erozionet, përmytjet, tërmetet, ndotjet, venddepozitat, subsidencat minerale, etj.);
- d) Studimi i mikrozonimit për vlerësimin e rrezikut sizmik, në nivel rajonal e vendor;
- dh) Përshtatja e standardeve europiane të projektimit antisizmik, në vendin tonë;
- e) Studimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë sizmike dhe i lëkundjeve të forta, si dhe njoftimi, në kohë reale, i organizmave shtetërore dhe i publikut;

ë) Studimet gjeofizike, rajonale e vendore, në kuadër të hartografimeve gjeologjike, të studimeve të gjeomjedisit, të arkeologjisë, energjisë gjeotermale etj;

f) Zhvillimi i modeleve gjeoinformatike;

g) Formimi universitar, kryesisht në ciklin e dytë e të tretë të studimeve dhe kualifikimi shkencor i shkencëtarëve të rinj.

4. IGJEO-ja kalon një periudhë kalimtare, nga një deri në dy vjet, gjatë së cilës organizohet në njësi përbërëse, departamente dhe grupe kërkimore-mësimore, si më poshtë vijon:

a) Departamenti i Gjeoresurseve dhe i Gjeoinxhinierisë;

b) Departamenti i Gjeofizikës dhe Gjeoriskut;

c) Departamenti i Sizmologjisë dhe Inxhinierisë Sizmike;

ç) Departamenti i Teknologjive të Gjeoinformacionit.

5. Organet dhe autoritetet drejtuese të IGJEO-s janë:

a) Këshilli drejtues;

b) Drejtoria;

c) Drejtori;

ç) Përgjegjësit e departamenteve.

6. Detyrat e këshillit drejtues të institutit

Këshilli drejtues drejton veprimtarinë e IGJEO-s gjatë periudhës kalimtare deri në zgjedhjen e organeve dhe të autoriteteve drejtuese të tij.

Detyrat kryesore të këshillit drejtues janë:

a) Harton kuadrin rregullator të veprimtarisë së IGJEO-s (rregulloret etj.);

b) Harton planin afatgjatë të zhvillimit të IGJEO-s dhe ia paraqet, për miratim, senatit akademik të UPT-së;

c) Përcakton fushat parësore të kërkimit dhe formimit universitar dhe, në varësi të tyre, i propozon senatit grupet kërkimore - mësimore, që do të ngrihen në IGJEO;

ç) Përcakton kriteret e punësimit të personelit akademik;

d) Drejton procedurat e konkurrimit të hapur, për emërimin e titullarëve të grupeve kërkimore - mësimore;

dh) Harton raportin vjetor të veprimtarisë (përfshirë atë financiar), si dhe atë përfundimtar, në mbyllje të periudhës kalimtare, dhe ia dërgon senatit, për miratim;

e) I propozon rektorit të UPT-së, në përfundim të periudhës kalimtare, shpalljen e zgjedhjeve të organeve dhe autoriteteve drejtuese të IGJEO-s, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë;

ë) Përgatit dhe drejton procesin e zgjedhjes së organeve kolegjiale dhe të autoriteteve drejtuese të IGJEO-s, në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.

7. Përbërja e këshillit drejtues të IGJEO-s

Këshilli drejtues përbëhet nga 9 anëtarë: nga drejtori, i cili është edhe kryetari i këshillit drejtues i këtij instituti, katër anëtarë të brendshëm, (përgjegjësit e departamenteve të IGJEO-s) dhe 4 anëtarë të jashtëm, të emëruar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në bazë të propozimit të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës.

Anëtarët e jashtëm janë figura të njohura në fushën akademike dhe të politikave të arsimit të lartë dhe shkencës.

Anëtarët e këshillit drejtues shpërblehen në bazë të vendimit nr.120, datë 27.1.1997 të Këshillit të Ministrave “Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollorë dhe materialeve të tjera të dokumetacionit shkollor”.

Nëndrejtori dhe kancelari i IGJEO-s marrin pjesë në mbledhjet e këshillit, pa të drejtë vote.

8. Detyrat dhe përbërja e drejtorisë së IGJEO-s

Drejtorja e IGJEO-s është autoriteti kryesor, i cili drejton, nën mbikëqyrjen e këshillit drejtues, veprimtarinë e përditshme të këtij instituti.

Drejtorja përbëhet nga:

a) Drejtori;

b) Nëndrejtori;

c) Kancelari.

9. Për periudhën kalimtare, Ministri i Arsimit dhe Shkencës emëron dhe shkarkon drejtorin, në bazë të propozimit të bërë nga Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës. Nëndrejtori emërohet dhe

shkarkohet nga drejtori i IGJEO-s. Kancelari emërohet dhe shkarkohet nga rektori i UPT-së, në bazë të propozimit të këshillit drejtues.

10. Departamentet e IGJEO-s drejtohen nga përgjegjësit e departamenteve, të cilët, për periudhën kalimtare, emërohen dhe shkarkohen nga drejtori i këtij instituti.

11. IGJEO-ja përfaqësohet në senatin e Universitetit Politeknik të Tiranës nga drejtori i tij dhe 2 (dy) anëtarë, personel akademik, që kanë, së paku, gradën “Doktor”, të cilët përzgjidhen nga këshilli drejtues, në bazë të propozimeve të bëra nga departamentet e këtij instituti.

12. Veprimtaria financiare dhe administrative e IGJEO-s realizohet përmes administratës qendrore të UPT-së.

Niveli i pagave të punonjësve të këtij instituti do të jetë i njëjtë me atë të personelit akademik respektiv në institucionet publike të arsimit të lartë.

Marrëdhëniet e punës së punonjësve rregullohen sipas dispozitave të ligjit për arsimin e lartë.

13. Në numrin e përgjithshëm të punonjësve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, miratuar me vendimin nr.244, datë 7.3.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve në ministrinë dhe institucionet qendrore, për vitin 2007”, shtohen 40 veta, për IGJEO-n, të cilët 15 veta pakësohen nga numri i punonjësve, të miratuar për periudhën 1 shtator - 31 dhjetor për Akademinë e Shkencave dhe 25 veta pakësohen nga numri i punonjësve, të miratuar për periudhën 1 shtator - 31 dhjetor për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, së bashku me fondet buxhetore, për paga dhe sigurime shoqërore, në vlerën 13 900 000 (trembëdhjetë milionë e nëntëqind mijë) lekë.

14. Për përmbushjen e detyrave të shërbimit sizmologjik, IGJEO-ja angazhon punëtorë, vrojtues-regjistruar, jashtë organikës, kundrejt një pagese, sipas tarifave të përcaktuara në vendimin nr.406, datë 19.6.1995 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

15. Struktura dhe organika e IGJEO-s përgatiten nga këshilli drejtues, në bazë të numrit të përgjithshëm të punonjësve, të miratuar në pikën 13 të këtij vendimi dhe miratohen nga rektori i UPT-së.

16. IGJEO-ja financohet nga Buxheti i Shtetit, i cili përfshihet brenda buxhetit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për UPT-në, si dhe nga burime të tjera, të ligjshme.

IGJEO-ja përfiton, në bazë të konkurrencës, nga programi i financimit shtetëror të projekteve për kërkim shkencor.

Gjithashtu, mund të përfitojë financime edhe nga subjekte private, të interesuara për kërkimin e tyre shkencor apo për ofrimin e shërbimeve a të të ardhurave, të krijuara brenda misionit të vet.

17. IGJEO-s, në UPT, i kalojnë të gjitha asetet (burime financiare, mjediset e punës, laboratorë, zyra, automjete, donacione, projekte kërkimi e zhvillimi, orendi, infrastrukturë, informatike, rrjet telefonik etj.), si dhe arkivat shkencorë e çdo dokumentacion tjetër arkivor i instituteve dhe i njësive, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi.

18. Ngarkohen Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe kryetari i Akademisë së Shkencave të përgatisin urdhrin e përbashkët, për inventarizimin dhe transferimin e aseteve të pasurive dhe ndarjen e tyre, përkatësisht për secilin institucion, sipas këtij vendimi.

19. Vendimi nr.165, datë 14.5.1962 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Institutit të Studimeve dhe Projektmeve të Gjeologjisë dhe Minierave”, shfuqizohet.

20. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, Akademia e Shkencave, Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.562, datë 22.8.2007

PËR SHKËPUTJEN E INSTITUTIT TË KËRKIMEVE BIOLOGJIKE NGA
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE INTEGRIMIN E TIJ NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit e Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkëputjen e Institutit të Kërkimeve Biologjike (IKB) nga Akademia e Shkencave dhe integrimin e tij, si pjesë përbërëse, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (FSHN), të Universitetit të Tiranës (UT), i cili do të organizohet, si më poshtë vijon:

a) Departamenti i Bioteknologjisë;

b) Seksioni i Florës, i Muzeut të Shkencave të Natyrës.

2. Misioni i njësive të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, përfshin:

a) formimin universitar të studentëve dhe shkencëtarëve;

b) kërkimin shkencor, bazë dhe të aplikuar;

c) shërbimet për të tretë, si dhe transferimin e njohurive e të teknologjisë, në fushat e bioteknologjisë, biologjisë molekulare dhe biodiversitetit.

3. Njësitë e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, organizohen dhe funksionojnë sipas dispozitave të Ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”. Detyrat dhe funksionimi i tyre përcaktohen në statutin dhe rregulloret e institucionit.

4. Në numrin e përgjithshëm të punonjësve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, miratuar me vendimin nr.244, datë 7.3.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve në ministrinë dhe institucionet qendrore, për vitin 2007”, shtohen 25 veta për FSHN-në, e UT-së, të cilët pakësohen nga numri i punonjësve, të miratuar për periudhën 1 shtator- 31 dhjetor për Akademinë e Shkencave, së bashku me fondet buxhetore për paga dhe sigurime shoqërore, në vlerën 8 680 000 (tetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

5. Struktura dhe organika e njësive të reja, që krijohen, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, përgatiten në bazë të numrit të përgjithshëm të punonjësve, miratuar në pikën 4 të këtij vendimi, dhe miratohen nga rektori i UT-së.

6. Pasuritë, e luajtshme dhe të paluajtshme (burime financiare, mjedise pune, laboratorë, zyra, automjete, donacione, projekte kërkimi dhe zhvillimi, orendi, infrastrukturë informatike, etj., si dhe arkivat shkencorë e çdo dokumentacion tjetër arkivor) të ish-IKB-së, kalojnë në pronësi të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, të Universitetit të Tiranës.

7. Ngarkohen Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe kryetari i Akademisë së Shkencave të përgatisin një urdhër të përbashkët, për inventarizimin dhe transferimin e aseteve të pasurive, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave, Universiteti i Tiranës dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.563, datë 22.8.2007

**PËR KRIJIMIN E QENDRËS SË FIZIKËS BËRTHAMORE TË ZBATUAR DHE
AUTORITETIT ATOMIK SHQIPTAR, PRANË UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Arsimit e Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Qendrës së Fizikës Bërthamore të Zbatuar (QEFIB), në bazë të ish-Institutit të Fizikës Bërthamore, të Akademisë së Shkencave, si njësi bazë, qendër kërkimi dhe zhvillimi, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, të UT-së.

2. Misioni i QEFIB-it përfshin:

- a) kërkimin shkencor, bazë dhe të aplikuar;
- b) formimin universitar të studentëve dhe shkencëtarëve;
- c) shërbime për të tretë, si dhe transferimin e njohurive e të teknologjisë, në fushat e fizikës bërthamore e të zbatuar.

Të gjitha shërbimet shtetërore, që realizonte Instituti i Fizikës Bërthamore, të Akademisë së Shkencave, bëhen pjesë e misionit dhe e detyrave të QEFIB-it.

3. Detyrat kryesore të QEFIB-it janë:

- a) Kërkimi shkencor dhe transferimi i njohurive, në sektorët e ekonomisë, shëndetësisë, kulturës, etj., në fushën e metodave dhe të teknikave bërthamore/atomike;
- b) Formimi i studentëve, i shkencëtarëve të rinj dhe kualifikimi i vazhduar i specialistëve në fushat/drejtimet e fizikës mjekësore, spektrometrisë fizike dhe fizikës së rrezatimeve;
- c) Mbështetja e Autoritetit Kombëtar Atomik, kryesisht, për zbatimin e procedurave dhe të kuadrit, ligjor e nënligjor, që lidhen me përdorimin paqësor të energjisë atomike;
- ç) Ofrimi i shërbimeve, në fushat e monitorimit integral të radioaktivitetit të mjedisit, mbrojtjes nga rrezatimet, aplikimit të metodave dhe teknikave të përparuara të fizikës, në fushat e prodhimit dhe në kërkim, si dhe mbështetja e laboratorëve, që përdorin metoda të përparuara fizike.

4. Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar organizohet në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Detyrat dhe mënyra e funksionimit përcaktohen në statut dhe në rregulloren e Qendrës.

5. Ngritjen e Autoritetit Atomik Shqiptar (AASH) si njësi pranë Qendrës së Fizikës Bërthamore të Zbatuar.

6. Autoriteti Atomik Shqiptar është një institucion shtetëror, me karakter teknik, që bashkërendon veprimtarinë kërkimore dhe siguron ekspertizën e shërbimet e nivelit më të lartë në fushën e metodave bërthamore, të monitorimit dhe mbrojtjes së punonjësve, publikut dhe mjedisit nga rrezatimet, të sigurimit bërthamor të instalimeve radiologjike dhe luftës kundër terrorizmit bërthamor.

7. Veprimtaria e Autoritetit Atomik Shqiptar mbështetet nga Këshilli i Autoritetit Atomik Shqiptar, si organ këshillimor pranë Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

8. Detyrat e Këshillit të Autoritetit Atomik Shqiptar janë:

- a) të përcaktojë përparësitë e zhvillimit të metodave dhe të teknologjive bërthamore në vendin tonë dhe të promovojë përdorimin e tyre, për qëllime paqësore;
- b) të bashkërendojë veprimtaritë me institucionet homologe të vendeve, rajonit dhe, veçanërisht, me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike;
- c) të analizojë çështje, që lidhen me mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese, dhe përdorimin e sigurtë të burimeve radioaktive;
- ç) të analizojë dhe të bëjë rekomandimet përkatëse, për problemet e sigurimit të materialeve dhe të instalimeve radiologjike dhe bërthamore.

9. Këshilli i Autoritetit Atomik Shqiptar përbëhet nga 7 anëtarë, si më poshtë vijon:

- a) Ministri i Arsimit dhe Shkencës, kryetar;
- b) Një përfaqësues nga Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës;

- c) Një përfaqësues nga Akademia e Shkencave;
- ç) Një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë;
- d) Një përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
- dh) Një përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- e) Një përfaqësues i Institutit të Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, të Universitetit Politeknik të Tiranës.

Anëtarët e këtij këshilli paguhen si anëtarët e senatit të universitetit.

10. Në numrin e përgjithshëm të punonjësve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, miratuar me vendimin nr.244, datë 7.3.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve në ministritë dhe institucionet qendrore, për vitin 2007”, shtohen 25 veta, për FSHN-në e UT-së, të cilët pakësohen nga numri i punonjësve, të miratuar për periudhën 1 shtator - 31 dhjetor për Akademinë e Shkencave, së bashku me fondet buxhetore, për paga dhe sigurime shoqërore, në vlerën 8 680 000 (tetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

11. Struktura dhe organika e njësive të reja, që krijohen, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, përgatiten në bazë të numrit të përgjithshëm të punonjësve, të miratuar në pikën 10 të këtij vendimi, dhe miratohen nga rektori i UT-së.

12. Të gjitha mjediset dhe asetet e tjera, në përdorim të ish- Institutit të Fizikës Bërthamore, kalojnë në varësi të FSHN-së, të UT-së.

13. Ngarkohen Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe kryetari i Akademisë së Shkencave të përgatisin urdhrin e përbashkët, për inventarizimin dhe transferimin e aseteve të pasurive, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

14. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM **Nr.566, datë 5.9.2007**

PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË SHPËRNDARJES SË FONDIT TË KOMPENSIMIT, NË TË HOLLA, PËR VITIN 2007

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Subjektet e shpronësuara, prona e të cilave është njohur e gjitha për kompensim dhe që i përket atyre qarqeve, rretheve apo qyteteve, për të cilat është miratuar harta e vlerës së pronës, që nuk kanë përfituar nga kompensimet financiare të mëparshme, të kompensohen, sipas radhës kronologjike, të përcaktuar nga numri i vendimit, sipas viteve.

2. Vlera e kompensimit të jetë e njëjtë, deri në 200 m² të sipërfaqes së përcaktuar për kompensim.

3. Subjektet, që kanë depozituar kërkesat e tyre në vitet 2005 e 2006 dhe vërtetojnë kryerjen e pagesës, nuk paguajnë tarifën e aplikimit, për vitin 2007.

4. Subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë, pranë zyrës së AKKP-së në qendër, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Formularin tip, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të plotësuar;
- b) Kërkesën për kompensim financiar, për pronën e njohur dhe të përcaktuar për kompensim;
- c) Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave/Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për njohjen dhe kompensimin e pronës;

- ç) Dëshminë e trashëgimisë;
 - d) Prokurën e posaçme, të nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm;
 - dh) Fotokopjen e noterizuar të dokumentit të identifikimit (pasaportë, certifikatë ose letërnjoftim) të personit, që ka prokurën e përfaqësimit;
 - e) Mandatpagesën.
5. Zyra e AKKP-së në qendër, në bashkëpunim me zyrat rajonale, shqyrton dokumentacionin e subjekteve, që kërkojnë kompensim dhe kryen veprimet e mëposhtme:
- a) Verifikon dosjen dhe vendimin përkatës, të dhënë nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave/Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave;
 - b) Verifikon në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, brenda 5 ditëve, konfirmojnë çdo të dhënë, vlefshmërinë dhe çdo të dhënë tjetër për vendimin përkatës;
 - c) Verifikon çdo dokument, që vërteton se prona ka ndryshuar gjendjen juridike të pronësisë, nga çasti i daljes së vendimit, në favor të subjektit të shpronësuar;
 - ç) Llogarit vlerën e kompensimit për secilin subjekt të shpronësuar;
 - d) Përgatit planvendosjen e pjesës përfituese të pronës, që kompensohet;
 - dh) Shpall listën e subjekteve përfituese në mjediset e zyrës qendrore dhe të zyrave rajonale të AKKP-së, si dhe në median e shkruar dhe atë elektronike;
 - e) Miraton vendimin e kompensimit, për secilin subjekt të shpronësuar, të shoqëruar me planvendosjen e pjesës përfituese të pronës, që kompensohet, vlerësimin dhe relacionin përkatës.
6. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në mbështetje të fondeve të planifikuara në Buxhetin e Shtetit, bën kalimin e fondit të kompensimit financiar, në emër të subjektit të shpronësuar, përfitues të kompensimit, apo të përfaqësuesit të tij me prokurë, në përputhje me procedurat për zbatimin e Buxhetit të Shtetit.
7. Procesi i regjistrimit/pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 ditë pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe vazhdon për 20 ditë.
8. Ngarkohet Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Formular Tip

K E R K E S E

PER FORMEN E KOMPENSIMIT TE PRONES

Drejtuar: Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

Data e paraqitjes se kërkesës: ____/____/____

Emri / Atësia / Mbiemri i subjektit te shpronësuar qe paraqet
kërkesën ____/____/____
Emri Atësia Mbiemri

Adresa: _____;
Tel. /Fax. _____

E-mail: _____

Kërkesë për formën e kompensimit të pronës (Shëno brenda kuadrateve një ose disa numra, nga 1 (një) deri ne 6 (gjashtë) sipas preferencës. Numri 1 tregon preferencën parësore dhe në mënyrë zbritëse numri 6 atë që ju preferoni më pak).

-- Me pronë të paluajtshme publike që ndodhet në zona me përparësi zhvillimin e turizmit.....

-- Me pronë tjetër të paluajtshme të të njëjtit lloj, me vlerë të barabartë, në pronësi të shtetit

- Me pronë tjetër të paluajtshme të çdo lloji, me vlerë të barabartë, në pronësi të shtetit.....

-- Me aksione në shoqëri me kapital shtetëror, ose ku shteti është bashkëpronar, që kanë vlerë të barabartë me pronën e paluajtshme.....

-- Me vlerën e objekteve, të cilat janë objekt i .privatizimit

-- Me të holla.....

Nënshkrimi i kërkuarit _____

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME**

BOTIME TË REJA *(Të përditësuara gusht 2007)*

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 11.9.2007
Doli nga shtypi më 11.9.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 16 lekë